



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1512/2 Prot
Nr. 863 Dosje

PERMBARUES GJYQËSOR
AGIM SULÇE
Tiranë, më 05.11.2018

URDHËR
PER MASEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
Adresa : Blv"Zhan D'Ark", prona nr.33, shtepia ushtarakeve, Tirane

Unë, Agim Sulce , me detyrën e Permbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.8445 akti të lëshuar më datë 17.10.2018 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr. 863 , Datë 25.10.2018 kërkesën e kreditorit Shoqeria "DIMAPAK" shpk ndaj debitorit Shoqeria " Dyrrakium " shpk , në lidhje me faturat tatimore nr.1889 date 18.07.2017, nr.1921 date 20.07.2017, nr.3429 date 21.12.2017 dhe nr. 663 date 14.03.2018.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin per Ekzekutim Vullnetar me shkresen Nr.1504 Prot, Datë 26.10.2018 , për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 8445 akti , datë 17.10.2018 i Gjyqates se Rrethit Gjyqësor Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile.

KONSTATOVA Se :

Ne baze te urdhrimit te ekzekutimit debitori Shoqeria "Dyrrakium " shpk detyrohet te shlyeje detyrimin ne favor te kreditorit Shoqeria "DIMAPAK" shpk ne masen 236,690 leke.

URDHËROJ

Vendosjen e Sekuestros Konservative per bllokimin e Kuotave/Aksioneve te cilat rezultojne ne emer te debitorit Shoqeria " Dyrrakium" shpk , me adrese : Rr."Hajdar Demiri", Lagjia 8, godine 1-kateshe, Durres dhe me nr.NIPT: J61810504P.

Ne rast mosbashkepunimi nga ana juaj do te procedojme me marrjen e masave administrative sic parashikon neni 606 i K.Pr. Civile.

Bashkelidhur : Urdhri i ekzekutimit, Vendim nr.8445 akti , date 17.10.2018, i Gjyqates se Rrethit Gjyqësor Tirane.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Agim Sulçe





Nr.8445 akti
Date .10.10.2018

Date 17.10.2018

V E N D I M

"Urdher Ekzekutimi"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : Arben Kostandini

sot më dt.17.10.2018 mori në shqyrtim në dhome keshillimi çështjen civile që i përket:

KERKUES: Shoqeria "Dimapak" shpk, me seli ne Rr."Myslym Shyri" Pll.10,shk.3 ,kati 2 Tirane , me NIPT K711822801C me administrator Fatbardha Dibra perfaqesuar me autorizim Date08.10.2018 ngaAv.Bledion Disha

OBJEKTI: Leshimin e urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes: Nr.1889 me seri 117571882 date 18.07.2017, Nr.1921 seri 117571914 date 20.07.2017, Nr.3429 seri 117573422 date 21.12.2017 dhe Nr.663 seri 117574178 date 14.03.2018.

BAZA LIGJORE: Neni 510-511 te Kodit te Proçedures Civile. Neni 5 dhe 16 te Ligjit Nr.48/2015 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare".

Gjykata pasi çmoi provat e paraqitura dhe shqyrtoi çështjen civile ne teresi;

V E R E N

Pala kerkuese Shoqeria "Dimapak" shpk, eshte person juridik i regjistruar prane Qendres Kombetare te Bisnesit dhe ushtron aktivitetin ne fushen e tregtimit te material e makineri ..., etj.

Mes kerkuesit Shoqeria "Dimapak" shpk dhe shoqeris "DYRAKIUM" shpk ka patur nje marrdhenie tregtimit te mallrave te ndryshem .

Per kete pala kerkuese rezulton te ketë lëshuar kundrejt subjekti 'DYRAKIUM' shpk faturat tatimore te shitjes Nr Nr.24 date 04.03.2015, Nr.25 date 11.03.2015, Nr.28 date 18.03.2015, Nr.35 date 31.03.2015 dhe Nr.50 date 29.04.2015 sipas objektit te kerkimit.

Sipas kerkimit të palës kerkuese nga ana e subjekti 'DYRAKIUM' shpk nuk rezulton që të jetë përbushur detyrimi për pagimin e çmimit të përcaktuar në faturen tatimore të shitjes të sipërcituar dhe për këtë shkak lidhur me kete fatur tatimore në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", duhet të lëshoheturdhëri i ekzekutimit .

Nisur nga sa u parashtrua më lart, çështja që do të merret në shqyrtim në rastin konkret nga ana e gjykatës është :

I. Nëse ekzistojnë apo jo kushtet për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturen tatimore të shitjes të lëshuara nga ana e kerkuesit në kuptim kjo të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare"?

I. Lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim :

Në nenin 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", dispozitë kjo e emërtuar : "Titulli ekzekutiv" parashikohet shprehimisht se :

"1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile".

Neni 511 i K. Pr. Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 114/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë dhe

Në nenin 510 gërma "e" të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se konsiderohen tituj ekzekutivë të gjitha aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin e tyre.

Kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga Gjykata në Dhomë Këshillimi pa prezencën e palës kërkueses, e cila në marrjen e vendimit shqyrtoi vetëm aktet e bashkangjitur kërkesës.

Sipas akteve të administruara në gjykim rezultoi se ;

Në rastin konkret në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezulton që të plotësohen kushtet për t'i konsideruar faturat tatimore të shitjes të lëshuar nga ana e kerkuesit përkundrejt 'DYRAKIUM' shpk si titull ekzekutiv për detyrimin për arsye se :

Së pari: Pala kërkuese rezulton ta ketë ofruar shërbimin subjekti 'DYRAKIUM' shpk.

Së dyti : Nuk rezulton që subjekti 'DYRAKIUM' shpk të ketë kundërshtuar furnizimin e ofruara nga ana kerkuesit.

Së treti : Nuk rezulton që të jemi në kushtet e përcaktimeve të nenit 485 të K.Civil.

Së katërti : Në kuptim të përcaktimeve të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", fatura tatimore e shitjes të lëshuara nga ana e kerkuesit rezulton që në kuptim të dispozitës së sipërcituar të konsiderohen tituj ekzekutivë, për zbatimin e të cilave ngarkohet shërbimi përmbarimor. Gjithashu ne baze te nenit 5 e 12 te Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" duhet te paguhen dhe kamatvonesat dhe gjobat.

PER KETO ARSYE

Ne referim te neneve 510 - 511 te K. Pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesës.

-Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturen tatimore Nr.1889 me seri 117571882 date 18.07.2017, Nr.1921 seri 117571914 date 20.07.2017, Nr.3429 seri 117573422 date 21.12.2017 dhe Nr.663 seri 117574178 date 14.03.2018 lëshuar nga Kreditori Shoqeria "Dimapak" shpk për subjekti debitorin shoqeria 'DYRAKIUM' shpk me seli ne Rr."Hajdar Demiri " godin njekateshe Dures me NIPT J61810504P me administrator Lulezim Xhymerti , mbi shumen e faturave te perllogariten nga permbaruesi gjyqesor ne fazen e ekzekutimit, kamatat ligjore ne perputhje me Nenit 5 te Ligjit Nr. 48/2014 dt.24.04.2014.

-Ngarkohet Shërbimi Përmbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te kerkuese.

-U shpall ne Tirane, sot me date 17.10.2018

SHPENZIMET GJYQËSORE

Takse pulle 200 Leke





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



PERMBARUES GJYQESOR
AGIM SULÇE

Nr. 1514/2 Prot
Nr. 863 Dosje

Tiranë, më 06.11.2018

URDHËR
PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa : Blv"Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtepia e ushtarakeve, Tirane

Per dijeni: Shoqeria "Dyrrakium" shpk
Adresa : Rr."Hajdar Demiri", Lagjia 8, godinel-kateshe, Durres

Unë, Agim Sulçe, me detyrën e Përmbaaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit, Vendim Nr. 8445 akti, të lëshuar më datë 17.10.2018 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdher duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 863, Datë 25.10.2018 kërkesën e kreditorit *Shoqeria "DIMAPAK" shpk* ndaj debitorit Shoqeria "Dyrrakium" shpk.

KONSTATOVA

Ne datën 05.11.2018, me shkresën nr.1512/2 Prot, kam vendosur sekuestro konservative prane QKB per bllokimin e kuotave dhe aksioneve per llogari te debitorit. Debitori Shoqeria "Dyrrakium" shpk ka likujduar detyrimin ne total ne masen 236,690 leke ne favor te kreditorit Shoqeria "DIMAPAK" shpk prane BKT ne llogarine e permbaaruesit gjyqesor.

Per keto arsye:

URDHËROJ

Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, mbi kuotat/aksionet të debitorit Shoqeria "Dyrrakium" shpk, me adrese: Rr."Hajdar Demiri", Lagjia 8, godine 1-kateshe, Durres dhe nr. NIPT: J61810504P.

1. **Të njoftohem dhe informohem** menjëherë në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana Juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.

PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT
AGIM SULÇE

Adresa: Rr. "Myslym Shyri" P.10, Sh.3, K. 2, Tirane Tel/Fax +355 42400728 Cel/ 0692077578

